

**AKT THEMELIMI  
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
"A.S SOLAR" SH.P.K**

Sot me datë 03.11.2022, në Tiranë në mbështetje të ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare", u hartua ky akt themelimi nga ortakët themelues të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar nga Z. Klaudi Veliu , Z. Endrit Bulica , Z. Fatush Tota si më poshtë vijon:

**NENI 1  
THEMELIMI DHE EMRI I SHOQËRISË**

Krijohet shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "A.S SOLAR" SH.P.K.

Shoqëria do të zhvilloje aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me Aktin e Themelit dhe Statutin e saj.

**NENI 2  
SELIA**

Selia e Shoqërisë ndodhet në Tiranë, Rruga Don Bosko, Pallati TID nr.1, Kati 1, objekt shërbimi nr.6 , Tiranë dhe rnund të ndryshojë selinë e saj me vendim të asamblesë së ortakëve.

**NENI 3  
FORMA**

Kjo Shoqëri është një Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar

**NENI 4  
OBJEKTI I VEPRIMTARISË**

Ndërtimin e centraleve prodhuese për prodhimin e enërgjisë së rinnovueshme impianteve fotovoltaikë. Projektim , zbatim , konsulenca inxhinierike , ndërtim i impianteve fotovoltaikë.

Import - Eksport, shitje - blerje energjje ndaj të tretëve sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

Studim , projektim , konsulenca realizim i shërbimeve të shpërndarjes së enërgjisë elektrike.

Tregtim dhe instalim , Import – Eksport të paisjeve elektro-mekanike, elektrike , elektronike, telekomunikacioni dhe hidraulike për diga , hidrocentrale , termocentrale, nënstacionë elektrike, linja të transmetimit të enërgjisë , impianteve fotovoltaikë dhe tregtimin e tyre me shumicë dhe pakicë brënda dhe jashtë vendit, dhënen e asistencës teknike për mirëmbajtjen, riparimin, prodhimin dhe instalimin e tyre si dhe të cdo materiali tjeter ndihmës të sistemit dhe rrjetit elektrik .

Projektim , zbatim , konsulenca inxhinierike , ndërtim i linjave të trasmetimit TL/TM/TU , mirëmbajtje të sistemeve dhe pajisjeve elektro-mekanike, elektrike , elektronike, telekomunikacioni për nënstacionë , hidrocentrale , termocentrale. Projekte elektromekanike dhe gjeotermale.

Kursime të enërgjisë në ndërtimesat industriale të kompanive private dhe shtetërore.

Projektimin, ndërtimin, instalimin dhe tregtimin e sistemeve të enërgjisë së rinnovueshme, parqeve diellore, turbinave të erës dhe sistemeve hidroelektrike të shfrytëzuara për vete ose për të tjerët . Studim,

projektim dhe instalim i impianteve të mbrojtjes kundra zjarrit dhe ngritjes së sistemeve elektronike të sigurisë dhe sistemeve të alarmit. Studimi i ndikimit mjedisor të projekteve të ndryshme në fushën e enërgjisë dhe në fusha të tjera të ushtrimit të aktivitetit.

### **NENI 5 KOHËZGJATJA**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë e pakufizuar (e pacaktuar), duke filluar nga data e rregjistrirnit në Qendren Kombëtare të Biznësit, me përjashtim të rastit të mbarimit të saj sipas kushteve të parashikuara në ligj ose me vendim të asamblesë së ortakëve,

### **NENI 6 KAPITALI THEMELTAR**

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100,000 lekë.

Ky kapital është tërësisht i nënshkruar dhe i shlyer nga ortakët e shoqërisë. Shoqëria mund të shtojë ose zvogëlojë kapitalin, në varësi të nëvojave dhe rezultateve te saj, sipas vendimit të ortakëve .

Kapitali themeltar i shoqërise është i përbërë nga kontributi i Ortakëvë të Shoqërisë :

- Z.Klaudi Veliu , zoteron 1 ( një ) kuotë me vlerë 60.000 ( Gjashtëdhjetëmijë ) lekë.
- Z.Endrit Bulica , zoteron 1 ( një ) kuotë me vlerë 20.000 ( Njëzetëmijë ) lekë.
- Z.Fatosh Tota , zoteron 1 ( një ) kuotë me vlerë 20.000 ( Njëzetëmijë ) lekë.

### **ORGANI DREJTUES**

### **NENI 7 ASAMBLEJA E ORTAKËVE**

Asambleja e Ortakëve zoteron të gjitha kompetencat që i njihen me ligj për shkak të kësaj cilësie.

### **NENI 8 ADMINISTRATOR**

Shoqëria do të drejtohet nga administratori i saj, Endrit Lepeden Bulica, i datëlindjes 10.03.1986, zotërues i kartës së identitetit me nr personal I60310095P.

### **NENI 9 FITIMI**

Të ardhurat neto të shoqërisë i takojnë ortakëve themelues të shoqërisë.

**NENI 10  
BILANCI**

Viti finanziar fillon në 1 janar dhe përfundon me 31 Dhjetor të cdo viti.

Llogaritë vjetore, inventari, raportet mbi operacionet e vtitit finanziar dhe raportet hartuara nga eksperti kontabel, miratohen nga asambleja e ortakëve.

Miratimi i dokumentave mbi veprimtarinë vjetore bëhet brënda një afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes së vtitit finanziar.

**NENI 11  
KONFLIKTET**

Konfliktet që mund të lindin midis palëve do të gjykohen në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, sipas statutit të shoqërisë, kontratës të lidhur me palët dhe në zbatim të legjislacionit shqiptar.

**NENI 12  
VULA DHE SHENJA DALLUESE**

Shoqëria ka vulën dhe shenjat e veta dalluese.

**NENI 13**

Ky akt themelimi do të hyjë në fuqi pas marrjes së lejes nga organet kompetente.

**NENI 14**

Akti i themelimit u perpilua në katër kopje origjinale ne gjuhën shqipe me vlerë të njëjtë.

**ASAMBLEJA E ORTAKËVE TË SHOQËRISË**

**Klaudi VELIU**

Klaudi Veliu



**Endrit BULICA**



**Fatush TOTA**

